



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit



Shkresë	17.04.2025
Nga:	ZPP Gentiana Qela
PER:	Babita sh.p.k
Lenda :	VENDIM

Në pajtim me nenin 108/A, paragrafi 10, nën paragrafi 10.2 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068 si dhe Ligjin 04/L-237 si dhe Ligjin nr. 05/L-092 si dhe Rregullores (A01) nr. 002/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Babita sh.p.k të datës 17.04.2025 kundër njoftimit per kontrate për procedure të prokurimit me numër 611-25-2641-1-1-1 ,me titull “” FURNIZIM ME MATERIAL ELEKTRIK VEGLARI DHE LLAQE,BUJQESORE DHE SANITARI”” datës 02.04.2025 , Komuna e Drenasit (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit sjell:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Babita sh.p.k të datës 17.04.2025 kundër njoftimit per kontrate të aktivitetit të prokurimit me numër 611-25-2641-1-1-1 me titull “FURNIZIM ME MATERIAL ELEKTRIK VEGLARI DHE LLAQE,BUJQESORE DHE SANITARI” e datës 02.04.2025
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdojë me njoftimin per kontrate të projektit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Babita sh.p.k.. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike e-prokurimi në adresën <http://e-prokurimi.rks-gov.net>
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar me kujdes kerkesen per ri-shqyrtim dhe e ka refuzuar sit e pabazuar duke sipas arsyetimit te meposhtem .

Autoriteti Kontraktues ka kerkuar qe OE ofertues te kene nje depo ne afersi te institucionit per arsye se paramasa ka te beje me matriale te imta dhe te cilat kerketat jane te shpeshta per shkak qe kemi shume institucione te Drenasit te perfshira ne kete kontrate qe jane : Komuna , shkollat dhe institucionet shendetsore dhe duke pase parasysh qe keto institucione kane shume kerketa per keto matriale te imta ne si Autoritet Kontraktues kemi pare te arsyeshem qe Operatoret pjesemarres ne kete procedure duhet te kene nje depo ne afersi ne menyre qe te kemi nje qasje me te shpejt drejt ketyre pozicioneve (kjo duke u nisur nga praktikat qe kemi pas me OE qe kane pas lokacione me te largta ku kemi pas vonesa ne furnizim dhe kan prit qe te kene kerketa ne sasi me te madhe ne menyre qe te bejen furnizim te menjehereshem duke u arsyetuar qe nuk kane llogari qe te vijne vetem per kete sasi) . Shkollat dhe institucionet nuk mund te presin periudha te gjata per furnizim pasi qe jane me te ndjeshme dhe kan te bejne me nxenes dhe pacienta .

Kunder ketij vendimi keni te drejte ankese ne OSHP ne afate prej 10 Dite .